



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë – Ministarstva Prade – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministra Pravde – Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 25 /2023
Datë: 25/01 /2023

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK) – Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr.04/2021 dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 03/2022, si dhe në pajtim me nenin 5 të Ligji nr. 02/l-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 10/2012 për organizimin, fushëveprimin dhe funksionimin e këshillit të përgjithshëm të shërbimeve sociale dhe familjare, i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr.06/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 10/2012 për organizimin, fushëveprimin dhe funksionimin e këshillit për shërbime sociale dhe familjare, si dhe Listës përfundimtare nga regjistri i profesionistëve dhe anëtarëve të emëruar nga institucionet e përcaktuara me Ligjin përkatës në fuqi, sipas komisionit vlerësues, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare (në tekstin e mëtejme: Këshilli), në këtë përbërje:
 - 1.1. Adile Shaqiri – Udhëheqëse e Divizionit për Shërbime Sociale, Ministria e Drejtësisë;
 - 1.2. Fitore Rexhaj - Zyrtare e Lartë për Inspektim, Ministria e Drejtësisë;
 - 1.3. Ganimete Shala - Zyrtare e Lartë për Zhvillim të Trajnimeve, Ministria e Drejtësisë;
 - 1.4. Merita Syla – SHKK, Ministria e Drejtësisë;
 - 1.5. Rreze Fetiu, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.6. Ylfete Abazi, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.7. Xhuljeta Humolli, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.8. Nafie Selimi, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.9. Kumrie Bytyqi, Regjistri i profesionistëve;

- 1.10. Lulkuqe Gashi., Regjistri i profesionistëve;
 - 1.11. Ganimete Murseli Brahimi, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.12. Anita Rashiti Fazliu, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.13. Vera Kolgjeraj, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.14. Fjolla Ibrahim Starabaja, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.15. Lutfi Bislimi, Regjistri i profesionistëve;
 - 1.16. Njomza Llullaku, Universiteti i Prishtinës;
 - 1.17. Natyra Agani, Universiteti i Prishtinës;
 - 1.18. Niman Bardhi, Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.19. Adelina Sahiti, Asociacioni i Komunave të Kosovës;
 - 1.20. Fahri Shabani, Asociacioni i Komunave të Kosovës;
 - 1.21. Gani Lluga, Organizatat Jo-Qeveritare.
2. Këshilli është përgjegjës për të gjitha çështjet nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
 3. Anëtarët e Këshillit nuk duhet të mbajnë asnjë pozitë që nuk është në pajtim me funksionet e tyre si anëtarë të Këshillit.
 4. Këshilli ka mandat katër (4) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.
 5. Anëtarët e Këshillit, për angazhimet e tyre në Këshill do të kompensohen në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
 6. Ministria e Drejtësisë siguron kushte të punës për funksionimin e Këshillit.
 7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i 'u dërgohet:

- *Anëtarëve të Këshillit;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*